



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Zyra e Kryetarit të Komunës

OPŠTINA LIPJAN
REPUBLIC OF KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar me:	05.10.2023	
Primitje:		
Njësia Jednica:	Numr. Broj:	Shtojca Dodatak:
01-052/01-57089		

PROCESVERBALI

NGA KONSULTIMI PUBLIK I

PLANIT PËR MENAXHIMIN

E MBETURINAVE

2023-2027

**PROCESVERBALI NGA KONSULTIMI PUBLIK I PLANIT PËR MENAXHIMIN E
MBETURINAVE 2023-2027**

INFORMATË RRETH NJOFTIMIT

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 67 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.03/2020 për transparencë në Komuna, Udhëzimit administrativ (MAPL) nr.06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në Komuna, Rregullores mbi Transparencën në Komunën e Lipjanit Nr. 15-353-35739 e datës 30.06.2021 si dhe Planit të Veprimit për transparencë në Komunë, dhe me qëllim të nxitjes dhe sigurimit të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe palëve të tjera gjatë procesit të politik bërjes dhe vendimmarrjes së Kuvendit të Komunës së Lipjanit, Kryetari i Komunës ka shpallur në:

KONSULTIM PUBLIK

Propozim Planin Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave **2023-2027**

Njoftimit i është bashkangjitur edhe linku i konsultimeve publike ku ka qenë në diskutim publik Propozim Planin Komunal për Menaxhimin e Mbeturinavesi edhe informatë shtesë se kujt i adresohen komentet.

Shih linqet:

<https://kk.rks-gov.net/lipjan/konsultimet-publike/dokumentet-ne-konsultim-publik/>

**PROCESVERBALI NGA KONSULTIMI PUBLIK I PROPOZIM PLANIN KOMUNAL PËR
MENAXHIMIN E MBETURINAVE 2023-2027**

INFORMATË RRETH NJOFTIMIT

Me datë. 29.08.2023 është publikuar njoftimi për mbajtjen e konsultimit-debatit publik Propozim Planin Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave.

Njoftimi është publikuar në uebfaqen zyrtare të Komunës dhe në rrjetet sociale të komunës.

<https://www.facebook.com/photo.php?fbid=684695533684798&set=pb.100064330733832.-2207520000&type=3>

<https://kk.rks-gov.net/lipjan/wp-content/uploads/sites/20/2023/10/Njoftim-per-debat-publik-i-skenuar.pdf>

Ndërsa me datë 08.09.2023 mbahet konsultimi publik në sallën e Kuvendit Komunal në Komunën, ju bashkangjesim lajmin e publikuar në ueb faqe:

<https://kk.rks-gov.net/lipjan/news/diskutohen-projekt-rregullorja-komunale-per-sherbimet-publike-dhe-rendin-komunal-si-dhe-plani-komunal-per-menaxhimin-e-mbeturinave-ne-komunen-e-lipjanit/>

Konsultimi publik realizuar në kohën e paraparë dhe filloi në orën 14:00 dhe ka përfunduar në ora 15:30

Këtë Propozim Plan e ka prezantuar nga Labinot Dedushi i cili njëherit ishte edhe Kryesues i grupit punues për hartimin e projektit të planit. Ai po ashtu ka prezantuar edheanëtarët e tjerë të grupit punues.

1. Hanushe Berisha, Drejtore për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, anëtare
2. Avni Sahiti, Drejtore për Inspektorat, anëtar
3. Behar Krasniqi, Sektori për Përfaqësim dhe çështje ligjore, anëtar,
4. Xhelal Krasniqi, KRM "Pastrimi", anëtar.

PROCESVERBALI NGA KONSULTIMI PUBLIK I PROPOZIM PLANIN KOMUNAL PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE 2023-2027

INFORMATË RRETH DEBATIT PUBLIK

Kryesuesi i Komisionit ka thënë para të pranishmëve se Komuna e Lipjanit ka përfillur të gjitha procedurat për të konsultuar me publikun këtë Plan e cila pritet të miratohet në seancën radhës së Kuvendit të Komunës dhe kërkoi nga të pranishmit që të japin vërejtjet dhe komentet e tyre rreth këtij drafti pasi ata e kanë mundësinë që të japin propozime konkrete rreth dispozitave të këtij Projekt Planit.

Kryesuesi i Komisionit Labinot Dedushi më pastaj ka vazhduar të prezantoj në pika të shkurta Planin në fjalë, ai para të pranishmëve ka thënë se Aktualisht shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbeturinave në tërë teritorin e Komunës së Lipjanit ofrohet nga operatori KRM “Pastrimi” Sh.A., njësia në Lipjan, kjo kompani grumbllon mbeturinat nga ekonomitë familjare, bizneset dhe institucionet në komunë dhe i transporton në deponinë sanitare rajonale. Ai po ashtu ka theksuar se në kuadër të këtij Propozim Planit është paraparë edhe zgjerimi i mbulimit me shërbim të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave Përmirësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave, Përmirësimi i efikasitetit operativ dhe të kostos e shumë çështje tjera



Diskutimi u bë në mënyrë të hapur dhe u diskutuan shumë çështje, duke përfshirë: bazen ligjore për hartimin e këtij Planit, obligimet e Komunës për nxjerrjen e tij, organet e përfshira për zbatimin e këtij plani si dhe çështja e vetëdijësimit të qytetarëve në ruajtjen e ambientit.



**PROCESVERBALI NGA KONSULTIMI PUBLIK I PROPOZIM PLANIN KOMUNAL PËR
MENAXHIMIN E MBETURINAVE 2023-2027**

INFORMATË RRETH DEBATIT PUBLIK

Arsim Jashari – asambleist nga Kuvendi i Komunës së Lipjanit është interesuar se në këtë draft Plan a janë paraparë mekanizma për zbatimin e tij dhe a janë paraparë gjopa ndaj personave që hudhin mbeturina në vendet jo adekuate të tyre pasi që çështja e mbeturinave është një dukuri shume e përhapur dhe prezente në teren.

Labinot Dedushi – Sqaroi se çdo gjë që është paraparë me planin është e harmonizuar dhe përcaktuar sipas dispozitave të Ligjit për Mbeturinat dhe se ëçshtë e gjobave është e rregulluar

Arsim Jashari – asambleist nga Kuvendi i Komunës së Lipjanit ka ngritur edhe çështjen e përfshirjes së vetëdijësimit të qytetarëve dhe personave tjerë dhe organizimin e kampanjave me qëllim të ngritjes së nivelit të vetëdijes së qytetarëve për mos hudhjen e mbeturinave në vendet dhe hapësirat jashtë lokacioneve ku janë të përcaktuara për hudhjen e mbeturinave.

Labinot Dedushi – ka thënë se në këtë plan janë paraparë edhe kampanja vetëdijësuese për këtë qëllim të cilat janë zhvilluar dhe do të nëpë shkollat e Komunës së Lipjanit.

PROCESVERBALI NGA KONSULTIMI PUBLIK I PROPOZIM PLANIN KOMUNAL PËR
MENAXHIMIN E MBETURINAVE

INFORMATË RRETH DEBATIT PUBLIK

Metodat e Konsultimit	Datat/kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve/konsultimin publik-kontribuesve
1. Konsultimet me shkrim/në mënyrë elektronike	30 ditë pranohen	15
2. Publikimi në ueb faqe	30 ditë	

Në këtë takim konsultativ kanë marrë pjesë 15 pjesëmarrës, prej tyre 9 femra dhe 6 meshkuj.

Bukurie Zejnullahu-Jashari

Zyrtare përgjegjëse për kordinimin e konsultimeve publike

